



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit  
Opština Gnjilane  
Municipality of Gjiçane  
Gilan Belediyesi

---

Strategjia e Komunës për Komunikim Publik  
2023 - 2027

Hartuar nga Grupi Punues për hartimin e Strategjisë për komunikim, grupi punues për konsultime publike dhe Zyra e Kryetarit të Komunës së Gjiçanit

Shtator, 2023

<b>Përmbajtja</b>	
HYRJE .....	3
PROFILI I KOMUNËS .....	3
<b>STRUKTURA E ADMINSITRATES KOMUNALE PER KOMUNIKIM ME PUBLIKUN .....</b>	<b>4</b>
KORNIZA LIGJORE.....	5
Rregulloret komunale .....	8
VIZIONI DHE MISIONI.....	8
Misioni:.....	8
STRATEGJIA DHE QASJA E KOMUNIKIMIT.....	9
OBJEKTIVI KRYESOR.....	9
NËN-OBJEKTIVAT .....	9
Objekti 1: Rritja e transparencës dhe besimit të publikut në administratën komunale të Gjilanit .....	10
Objekti 2: Rritja e motivimit dhe performancës të të punësuarve në administratë dhe përmirësimi i strukturës dhe mekanizmit komunikues në komunë .....	10
AUDIENCA E SYNUAR .....	11
KOMUNIKIMI DHE MESAZHET .....	12
Matja e rezultateve .....	12
TRANSPARENCA – KOMUNIKIMI DHE PJESEMARRJA E PUBLIKUT .....	13
DOBITE E KOMUNIKIMIT .....	13
DOBËSITË E KOMUNIKIMIT.....	13
PLANI VJETOR I KOMUNIKIMIT .....	13
PLATFORMA DHE KANALET PËR KOMUNIKIM.....	14
SHTOJCAT.....	15

## HYRJE

Qëllimi i kësaj strategjie komunale të komunikimit është që të sigurojë avancimin e praktikave dhe kapaciteteve komunikuese të Komunës së Gjilanit. Përdormi i praktikave të mira të komunikimit efektiv me akterë të ndryshëm arrihet përmes zhvillimit të komunikimit të mirëfilltë. Llogaridhënia dhe transparenca kundrejt qytetarëve mund të realizohet në mënyrë sa më aktive në procese të ndryshme vendimmarrëse, duke përfshirë edhe mekanizmat e procesit të konsultimit publik në përgjithësi, e cila realizohet nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë mes komunës dhe qytetareve.

Kësisoj fitohet besimi i qytetarëve, duke i respektuar ata dhe në të njëjtën kohë duke implementuar transparencën komunale, ku qytetarët marrin informata të hollësishme në mënyrë që të jenë në gjendje të kërkojnë llogari nga autoritetet komunale, nëse ka edhe keqpërdorime dhe kjo do të rezultojë në të mirën e përbashkët.

Kontributi dhe roli i Komunës duhet të mbështetet fuqishëm në një strategji sa më efektive të komunikimit, ku përqendrimi kryesor duhet të jetë përmirësimi i praktikave të komunikimit dhe rritja sa më e madhe e motivimit dhe performancës së zyrtarëve komunalë në përmirësimin e performances organizative, ekipore dhe individuale.

Duke pasur parasysh që Komuna e Gjilanit nuk ka strategji të komunikimit, është parë e udhës që të hartohet Strategjia e komunës për komunikim, e cila do të shërbejë si udhërrëfyes në mënyrë që të implementohen parimet dhe praktikave të komunikimit, konsultimit dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje. Gjithashtu, përmes kësaj strategjie synohet të arrihet një bashkëpunim i ngushtë me komunitetin, shoqërinë civile, mediat, donatorët, bizneset etj.

Autoritetet komunale synojnë që të kenë përfshirje sa më të madhe të personelit të administratës komunale, sidomos në funksion të komunikimit të brendshëm, e me këtë të krijohet një potencial për menaxhimin e suksesshëm të komunikimit të jashtëm.

Të gjitha këto, në këtë dokument do t'u shërbejnë akterve të ndryshëm në ngritjen e imazhit dhe reputacionin e komunës, si dhe do të shërbejnë në rritjen e mirëbesimit në raport me qytetarët dhe kultivimin e marrëdhënieve të shëndosha me të gjitha audiencat e synuara.

Kjo Strategji e Komunës për komunikim është zhvilluar duke marrë në konsideratë edhe shkëmbimin e ideve dhe përvojave të ndryshme, vite më parë, duke e mos anashkaluar edhe trendin e zhvillimeve në këtë fushë, sidomos komunikimin digjital dhe konvencional.

Hartimi i këtij dokumenti është zhvilluar me mbështetjen teknike dhe profesionale të Aktivitetit të USAID Kontrata Sociale.

## PROFILI I KOMUNËS

Gjilani gjendet në pjesën lindore të Kosovës dhe është njëra nga shtatë komunat e mëdha të Republikës <sup>1</sup>.

Sipas regjistrimit të vitit 2011, komuna e Gjilanit ka 90,178 mijë banorë. Rreth 35 mijë të tjerë llogaritet se jetojnë në diasporë. Hapësira e komunës shtrihet në 392 km/2 dhe përbëhet prej 42 zonave kadastrale. Gjilani është larg nga Prishtina, kryeqendra e Kosovës, 46 kilometra, nga Kamenica – 27 km, nga Vitia – 22 km, nga Artana – rreth 25 kilometra. Njëherazi, Gjilani është edhe qendër e rëndësishme e mikro-regjionit të lindjes.

Me komunat e regjionit kufizohet, në juglindje me Preshevën (33 km) dhe Kumanovën (53), ndërsa në lindje – me Bujanocin (40 km). Komuna e Gjilanit, është binjakëzuar me komunat Yldirim (Turqi), Kukës (Shqipëri), Ipper (Belgjikë), Luterbah (Francë) dhe të tjera. Komuna e Gjilanit është fituese e çmimit “Diploma Evropiane” (2005) që e ndan Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, e çmimit “The Best City Model Award” në panairin e Cyrihut (maj 2015) dhe të tjerë. Komuna e Gjilanit është pranuar në Konventën e Kryetarëve të Parlamentit Evropian (tetor 2015).

## STRUKTURA E ADMINSITRATES KOMUNALE PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN

### Struktura e Administrates komunale<sup>2</sup>

Komuna e Gjilanit ka Kuvendin e Komunës i cili është organ më i lartë legjislativ i Komunës dhe Kryetarin e Komunës është organi më i lartë ekzekutiv i komunës. Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë, i cili zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me ligjin për zgjedhjet lokale. Kuvendi i komunes se Gjilanit ka dy komitetet te perhershme Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komuniteteve, sipas nevojës mund te themelohen edhe komitetet tjera keshilldhenese apo konsultative.

Kryetari i Komunës zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejt nga qytetarët që kanë të drejtë vote në komunë, në përputhje me Ligjin mbi zgjedhjet komunale në fuqi. Kryetari i Komunës zgjedhet për mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës në pajtim me ligjin.

Administrata komunale organizohet në drejtori ku përfshijnë:

1. Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme;
2. Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
3. Drejtorinë e Arsimit;

<sup>1</sup> <https://kk.rks-gov.net/gjilan/qyteti/>

<sup>2</sup> <https://kk.rks-gov.net/gjilan/wp-content/uploads/sites/11/2021/12/Organogrami-2018.pdf>

4. Drejtorinë për Buxhet dhe Financa;
5. Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit;
6. Drejtorinë e Inspektionit;
7. Drejtorinë për Shërbime Publike, Infrastruktura dhe Banim;
8. Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë;
9. Drejtorinë për Rini, Kulturë dhe Sport;
10. Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi, Prone;
11. Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim;
12. Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik;

### **Komuna dhe kanalet e informimit**

Komuna e Gjilanit e ka Zyren Komunale për Informim (ZKI) që në përbërjen e saj ka 2 zyrtarë – zyrtarin për informim dhe udhëheqësin e ZKI. Po ashtu në kuadër të kabinetit të Kryetarit është emëruar një zyrtar përgjegjës për marrëdhënie me publikun. Përveç kësaj, rishtas është plotësuar Vendimi nr. 02/848 i datës 16/08/2022 për Grupin Punues për Pjesëmarrjen e Publikut, i cili në përbërjen e tij ka nga një përfaqësues të të gjitha njësive organizative relevante në fushën e komunikimit me qytetarë. Këto kapacitete mbështetën nga Drejtoria e Administratës.

Komuna, respektivisht ZKI përditëson uebfaqen e Komunës, ku vazhdimisht publikohen njoftimet për mbledhjet, takimet e Kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës, komiteteve obligative (KPF dhe KK) dhe planet e raportet e Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, si dhe koordinon publikimin e shpalljeve, konkurseve dhe njoftimeve si dhe të gjitha informatat dhe publikimet tjera me rëndësi për qytetarët dhe opinionin e gjerë.

Krijimi i një ure lidhëse ndërmjet qytetarëve dhe pushtetit lokal, përmes zyrës së komunikimit, publikimeve në rrjetet sociale, billbordeve dhe programeve mediatike ka arritur që të qytetarët të reflektojnë si një pushtet transparent dhe i qasshëm. Webfaqja e Komunës së Gjilanit, sikurse edhe webfaqet e komunave të tjera, aktualisht kanë probleme të shumta të qasjes në informata dhe kjo përgjegjësi e mirëmbajtjes nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka kaluar tash e disa muaj tek Agjencia Shtetërore e Informacionit (ASHI).

### **KORNIZA LIGJORE**

Korniza Ligjore e hartimit të kësaj Strategjie është i mbështetur në parimet dhe dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Vetëqeverisje lokale, si dhe rregulloreve dhe udhëzimeve administrative që ndërlidhen me informimin e publikut, transparencën e komunave dhe po ashtu nga aktet juridike komunale. Pra, parimet e qeverisjes së mirë janë normuar në legjislacionin vendor në mënyrë të mjaftueshme për të ndërtuar obligimet dhe përgjegjësitë e organeve komunale por edhe të qytetarëve.

**Kushtetuta e Republikës së Kosovës** - ka garantuar të gjithë qytetarëve mbi moshën 18 vjeç, të drejtën për pjesëmarrje në zgjedhje dhe të drejta zgjedhore dhe po ashtu ka garantuar pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike. Për me tej, Kushtetuta ka garantuar se vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë dhe që vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike dhe siguron, përveç tjerash, pjesëmarrje aktive të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

**Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale** - Qëllimi i Kartës Evropiane për vetëqeverisje lokale është të plotësojë mungesën e standardeve të përbashkëta evropiane për matjen dhe garantimin e të drejtave të organeve lokale, të cilat janë më pranë qytetarëve dhe t'i japin qytetarëve mundësinë e pjesëmarrjes efektive në marrjen e vendimeve me ndikim për interesin e përgjithshëm. Ajo demonstroi në nivelin evropian vullnetin politik, për t'i dhënë jetë në të gjitha nivelet e administrimit territorial, parimeve të mbrojtura që prej miratimit të saj nga Këshilli i Evropës.

**Ligji NR. 03 / L- 040 për Vetëqeverisje Lokale** në Kreu-n IX, Demokracia e drejtpërdrejtë dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve, ka përcaktuar kërkesat minimale ligjore sa i përket procesit të konsultimit me qytetarët. Komunitetet obligohen që të mbajnë periodikisht së paku dy herë në vit takime publike, në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Përveç takimeve publike të cekura më lartë, komunitetet janë të obliguara t'i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik dhe lidhur me këtë kanë në obligim që të nxjerrin Rregulloren komunale për transparencën e organeve legislative, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës.

**Ligji NR.06 / L-081 për Qasje në Dokumente Publike** Ligji për Qasje në Dokumente Publike i garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike dhe zbatohet për të gjitha dokumentet që mbahen, hartohen apo pranohen nga institucionet publike. Ky ligj obligon çdo institucion minimalisht të caktojë zyrtarin për komunikim me qytetarë pas marrjes dhe shqyrtimit fillestar të kërkesës për qasje në dokumente zyrtare duhet të vlerësojnë se cila është njësia përkatëse brenda institucionit publik që duhet ta ketë dokumentin e kërkuar.

#### **Ligji NR. 05 /L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative**

Ky Ligj ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave.

**Ligji Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale** Ky ligj përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Përmes këtij ligji përcaktohen përgjegjësitë e institucionit

përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave dhe qasjes në dokumente publike.

**UA nr. 06/2018 i MAPL-së për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna** - autoritetet lokale kanë ndërmarrë të gjitha veprimet për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara gjatë procesit të politikbërjes në komuna, të promovojë transparencë komunale, si dhe të ndikojë në zhvillimin e politikave të qëndrueshme në interes të përgjithshëm. Përmes këtij udhëzimi administrativ janë përcaktuar rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave dhe akteve nënligjore të komunës, dhe së dyti, që këto procedura të aplikohen në mënyrë uniforme në gjitha komunat, duke siguruar uniformitetin e nevojshëm për pjesëmarrjen qytetare dhe të ndikojë njësojë në forcimin e parimit të transparencës dhe demokracisë.

**Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane** - ka për qëllim që të rregullojë organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, në ushtrimin e disa aktiviteteve që janë në përgjegjësi dhe kompetencë të komunës. Udhëzimi përcakton themelimin, formën dhe mënyrën e bashkëpunimit të komunës me Këshillat Lokale për çështjet e interesit publik. Në qendër të rregullimit janë Këshillat lokale që nënkuptojnë trupat e zgjedhur që përfaqësojnë në mënyrë të organizuar komunitetin e një apo më shumë fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

**Udhëzimi Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-Faqet e Institucioneve Publike** - është dokument që përcakton standardet, formën, dukjen dhe karakteristikat e tjera që duhet të kenë të gjitha uebfaqet e institucioneve publike, duke përfshirë edhe ato të komunave.

**Udhëzimi Administrativ nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna** - ka për qëllim forcimin e transparencës së organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative komunale, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivelin lokal dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumentet zyrtare të komunës.

**Rregullore (MAPL) nr. 01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës** - që përcakton unifikimin e teknikës juridike, strukturës dhe procedurës së hartimit, si dhe publikimit të akteve të komunës. Dispozitat e kësaj rregullore janë të detyrueshme për të gjitha organet e komunës që hartojnë, miratojnë dhe publikojnë aktet e tyre. Secila komunë përmes këtij akti obligohet të emërojë një zyrtar përgjegjës që bashkërendon procesin e hartimit të akteve normative me të gjitha njësitë brenda komunës, të cilat janë të obliguara të ofrojnë ndihmë sipas kërkesave të tij, si dhe sipas nevojës, bashkërendon punën me Zyrën ligjore dhe njësitë tjera përkatëse për integritet evropiane dhe atë të financave.

**Rregullorja (QRK) NR. 27/2018 për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun** Me këtë rregullore përcaktohet funksionimi i një sistemi koherent dhe të koordinuar për komunikimin qeveritar me publikun. Gjithashtu, përcaktohen parimet dhe instruksionet lidhur me komunikimin e mirefillte me publikun.

## Rregulloret komunale

Në nivel komunal të legjislacionit, komunat janë të udhëzuara që të nxjerrin Rregulloret Komunale për Transparencë, përmes të cilave do të promovojnë punën transparente të organeve dhe të administratës së komunës. Qëllimi i kësaj rregulloreje është rritja dhe forcimi i transparencës në punë të organeve të komunës, Kuvendit të Komunës, Kryetarit të Komunës dhe organeve të Administratës: drejtorive komunale, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, ndërmarrjeve publike, lokale dhe rritjes së pjesëmarrjes të publikut në vendimmarrje në nivel lokal. Gjithashtu, krijimi i rregullave që mundësojnë ushtrimin sa më të lehtë të mundshëm të kësaj të drejte, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivelin lokal dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumentet publike komunale.

Pjesëmarrja dhe komunikimi me publikun rregulloret edhe me Statutin e komunës, përkatësisht në kapitullin e trete ku thuhet se Komuna duhet ta konsultojë publikun në mënyrë që t'i sigurojë, se vendimet e marruara janë të bazuara fuqishëm në fakte dhe që janë marrë parasysh pikëpamjet dhe përvojat e qytetarëve, si dhe që janë përdorur mundësitë e reja dhe kreative para marrjes së vendimit dhe që të gjitha vendimet e propozuara mund të zbatohen efektivisht në praktikë. 2. Komuna gjithashtu duhet t'i sigurojë qytetarët, që të kenë mundësi ta shprehin mendimin e tyre paraprakisht para se vendimi të aprovohet në Kuvendin Komunal, e që vendimi domosdoshmërisht duhet të ketë mbështetjen nga qytetarët në fazën e implementimit 3

## VIZIONI DHE MISIONI

**Komuna e gatshme që të ofrojë qeverisje të mirë, efektive dhe llogaridhënese për qytetarët e saj.**

Vizioni i qeverisjes së mirë është që komuna Gjilanit të jetë më transparente, përfaqësuese, përgjegjëse, llogaridhënese dhe më efikase në zbatimin e ligjit me përpikëri.

Përmes kësaj strategjie qytetarët e komunës së Gjilanit do të jenë të informuar për zhvillimet komunale, për proceset e vendimmarrjes, me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës para qytetarëve dhe institucioneve të tjera relevante.

Misioni:

Komuna përmes punëve efektive dhe duke përdorur resurset në mënyrë ekonomike, efektive dhe eficientë, komuna synon të përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve.

Përmes angazhimit dhe përpjekjes efikase për cilësinë e jetës së qytetarëve, komuna siguron ndihmë dhe ofron burime të qasshme për të gjithë qytetarët. Qëllimi parësor i dizajnit të komunikimit të brendshëm është që ta bërë administratën komunale një ambient të pëlqyer të punës, me personel të informuar në detaje dhe të përkushtuar si dhe të fuqizohet edhe më tutje për të qenë një institucion i aftë për t'i paraprirë dhe përshtatur ndryshimeve. Ky qëllim synohet përmes objektivave të matshme dhe të arritshme të cilat promovojnë vlera të larta

<sup>3</sup> <https://kk.rks.gov.net/gjilan/wp-content/uploads/sites/11/2022/09/Statuti-Komunes.pdf>



të punës së administratës komunale, të inkurajojë punën ekipore dhe efektive si dhe të nxis dhe promovojë ide inovative.

## STRATEGJIA DHE QASJA E KOMUNIKIMIT

Komuna e Gjilanit e ka për obligim që të sigurojë shërbime publike cilësore, që janë në përgjegjësi të saj. Në komunën e Gjilanit është vërejtur se ka mungesë të planit strategjik të komunikimit dhe si rezultat i kësaj mungon një strategji efektive e komunikimit me publikun. Për këtë arsye, është parë më se e nevojshme zhvillimi i një strategjie komunale të komunikimit me të gjithë të interesuarit në komunë, në mënyrë që transparenca kundrejt publikut të rritet dhe në të njëjtën kohë edhe ndaj partnerëve.

### OBJEKTIVI KRYESOR

Qëllimi kryesor i Strategjisë Komunale të Komunikimit do të zbatohet përgjatë periudhës 2023 - 2027 do të jetë:

1. Rritja e transparencës dhe mirëbesimit publik te administratës komunale që shërben në promovimin e angazhimit të qytetarëve, si dhe rritjen e vetëdijesimit dhe të kuptuarit sa më mirë të politikave, iniciativave dhe shërbimeve komunale për gjithë qytetarët e komunës së Gjilanit.
2. Rritja e motivimit dhe performancës të të punësuarve në administratë dhe përmirësimi i strukturës dhe mekanizmit komunikues në komunë.

### NËN-OBJEKTIVAT:

Qëllimet specifike nga aktivitetet e përcaktuara në Strategjinë Komunale të Komunikimit janë si më poshtë:

1. Të përmirësojë nivelin e të kuptuarit të administratës komunale në shoqërinë kosovare me theks tek qytetarët e Komunës;
2. Të rrisë ndërgjegjësimin për përfitimet e Komunës dhe se si publiku mund t'i përdorë ato;
3. Komunikimi proaktiv i aktiviteteve të vazhdueshme ndërmjet të gjithë akterëve;
4. Ndërtimi i partneriteteve me OJQ-të lokale dhe bizneset, për t'i angazhuar ato si akterë të zëshëm që do të marrin pjesë aktive dhe do të ushtrojnë presion publik mbi infrastrukturën publike institucionale të Komunës.

## **Objektivi 1: Rritja e transparencës dhe besimit të publikut në administratën komunale të Gjilanit**

Strategjia për komunikim të jashtëm do të shërbejë si një bazament për diversifikimin e komunikimit me qëllim të fuqizimit të informimit publik, ndërtimin e partneritetit të komunës me qytetarët, rritjen e transparencës, promovimin e vlerave dhe aseteve të komunës, e për rrjedhojë edhe përmirësimin e imazhit dhe reputacionit të komunës. Rritja e transparencës dhe besimit të publikut në administratën komunale është një synim thelbësor për komunën e Gjilanit. Kjo përfshin strategji dhe iniciativa të ndryshme që synojnë t'i bëjnë operacionet e komunës më të hapura, të përgjegjshme dhe më të aksesueshme për publikun. Në përgjithësi, rritja e transparencës dhe besimit të publikut në administratën komunale është një përpjekje e shumanshme që përfshin ndryshime politikash, përparime teknologjike dhe një përkushtim për qeverisje të hapur dhe të përgjegjshme. Kjo përfundimisht çon në marrëdhënie më të forta midis komunës dhe zgjedhësve të tyre, duke nxitur një qytetari më të angazhuar dhe më të informuar. Qeverisja e mirë varet nga jetësimi i suksesshëm i disa elementeve kyçe të administrimit, siç janë transparenca, përfaqësimi, pjesëmarrja, përgjegjësia, llogaridhënia, efektiviteti dhe efikasiteti, si dhe sundimi i ligjit.

### **Veprimet:**

- Rritja e transparencës nga ana e komunës dhe ndërtimi i besimit të publikut në administratën komunale.
- Zbatimi i masave dhe politikave që i bëjnë veprimet, vendimet dhe proceset që komuna të jetë më e hapura dhe të qasshme për publikun. Duke vepruar kështu, administrata komunale duhet të kërkojë të nxisë llogaridhënie, angazhim dhe besim më të madh në mesin e komunitetit të cilit i shërben.
- Komuna duhet të angazhohet në planifikim dhe organizim sa më të mirë të dëgjimeve buxhetore duke ofruar kushte sa më të mira për pjesëmarrje më të madhe, duke siguruar transparenca dhe interaktivitet.
- Komuna duhet të adoptojë forma të reja të organizimit të takimeve publike, dëgjimeve buxhetore, nismave të komunitetit, fushatave informuese, konsultimeve publike, etj.
- Paraqitja vizuale e objektivave të komunës, planeve zhvillimore, projekteve strategjike, janë mënyra e duhur për të siguruar pjesëmarrje dhe ofruar transparenca në punën e komunës.

## **Objektivi 2: Rritja e motivimit dhe performancës të të punësuarve në administratë dhe përmirësimi i strukturës dhe mekanizmit komunikues në komunë**

Rritja e motivimit dhe performancës së punonjësve brenda një administrate komunale, duhen të përmirësohen mekanizmat e komunikimit dhe operacionale me qytetarë. Kjo përfshin zbatimin e strategjive dhe praktikave për të rritur entuziazmin dhe produktivitetin e punonjësve në rolet e tyre brenda komunës, si dhe riorganizimin e kanaleve të komunikimit dhe optimizimin e proceseve administrative për efikasitet më të madh. Qëllimi është të krijohet një fuqi punëtore më e angazhuar dhe produktive, duke çuar në fund të fundit drejt qeverisjes komunale dhe ofrimit të shërbimeve sa më të mira dhe cilësore.

#### **Veprimet:**

- Marrja e mendimeve të të punësuarve mbi praktikën e komunikimit dhe ambientet e punës përmes metodave të ndryshme (anketime ose biseda individuale)
- Organizimi i ngjarjeve atraktive në fund të vitit me zyrtarë të administratës komunale duke i shpërblyer apo falënderuar kontribuuesit më të mëdhenj.
- Zhvillimi efikas i pakove të trajnimeve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të zyrtareve komunale
- Intervenimet e tilla të shoqërohen me ofrimin e mesazheve të mira të komunikimit që synojnë rritjen e motivit tek të punësuarit.

Ky intervenim fokusohet në dy objektiva kyçe brenda komunës:

- 1) rritja e motivimit dhe performancës së punonjësve
- 2) rritja e mekanizmave të komunikimit dhe administrativ.

Kjo iniciativë synon të frymëzojë dhe angazhojë punonjësit për të përmirësuar performancën e tyre të punës, duke përmirësuar njëkohësisht kanalet e komunikimit dhe proceset administrative brenda komunës për operacione më efikase dhe ofrim më të mirë të shërbimeve .

#### **AUDIENCA E SYNUAR**

Strategjia e Komunës për Komunikim në radhë të parë do të fokusohet në angazhimin me disa grupe synuara që do të komunikohen përmes kanaleve dhe aktiviteteve të ndryshme të cilat janë të përcaktuara në vazhdimësi:

1. Qytetarët e komunës;
2. Institucionet komunale dhe qendrore
3. Organizatat e Shoqërisë Civile (donatorët, bizneset, sipërmarrësit, sindikatat, përfaqësuesit e grupeve të marginalizuara etj).
4. Mediat lokale dhe qendrore
6. Turistët dhe vizitorët

## KOMUNIKIMI DHE MESAZHET

**Komuna duhet ta zbatojë formën e komunikimit dhe mesazhet të plasohen me aktivitetet si më poshtë:**

- Paratë e mbledhura nga qytetarët u kthehen qytetarëve në projekte konkrete duke e përdorur dhe realizuar buxhetin në mënyre transparente që qytetarët të kenë një pasqyrë të qartë të këtij procesi
- Pjesëmarrja e qytetarëve e rrit presionin qytetare për arritjen e qëllimeve kundër korrupsionit dhe keqpërdorimit të buxhetit komunal, me këtë komuna synon të jetë lidere në luftë kundër dukurive negative
- Qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit publik janë mbikëqyrës plotësues në punën tonë
- Shembujt pozitiv do të vlerësohen, ndërsa ata negativë do të përmirësohen
- Komuna transparente, llogaridhënëse dhe përgjegjëse në raport me publikun e gjerë

Forma dhe ideja e komunikimit në mënyrë që të ndërtojmë marrëdhënie të forta me publikun është të respektojmë rregulla të thjeshta komunikimi në çdo aktivitet që do të ndërmarrim:

- Komunikimi duhet të jetë i thjeshtë, i kuptueshëm, profesional, modern dhe kreativ, duke përdorur kanale të reja komunikimi, për të arritur të popullata e re dhe e moshës së mesme si dhe të shtyrë.
- Mënyra e komunikimit: i qartë dhe me mesazh të saktë, të dëgjuarit me vëmendje dhe me përgjigje të duhur, argëtuese;
- Komunikimi duhet të jetë në formë bashkëpunimi.

Qëllimet kryesore dhe specifike të përcaktuara më sipër duhet të japin rezultatet e pritshme të mëposhtme:

- Rritet përgjegjësia për rolin dhe aktivitetet e komunës;
- Informohet publiku i gjere një masë dhe të dëgjohet zëri kritik që do të jetë një vëzhgues aktiv, shoqëruar në monitorimin e aktiviteteve publike komunale;
- U jepet qytetarëve ide të qartë se cilat janë keqpërdorimet në institucionet publike dhe si mund të minimizohet dhe/ose të eliminohen nëse ka presion publik.
- Publiku i informuar me përfitimet nga funksionimi i komunës, dhe si po vihen në funksion paratë e kthyera në buxhet për përmirësimin e jetës së qytetarëve;

Matja e rezultateve

Matja e rezultateve do të bëhet me një studim dukshmërie që do të masë: - informimi për Komunën dhe aktivitetet e saj;

- Informimi për përfitimet që vijnë nga aktivitetet e komunës;
- Niveli i përfshirjes së qytetarëve, organizatave të biznesit e profesionale si dhe OJQ-ve që veprojnë në territorin e komunës dhe që kanë ndikim në veprimtarinë e saj.

## TRANSPARENCA – KOMUNIKIMI DHE PJESEMARRJA E PUBLIKUT

Komuna e Gjilani ka treguar performancë të mirë në fushën e komunikimit publik, përfshirë edhe pjesëmarrjen e publikut në proceset vendimmarrëse. Kjo është dëshmuar në kuadër të SMPK-së dhe raporteve të tjera të organizatave kredibile vendore dhe ndërkombëtare.

Në vitin 2023, Komuna e Gjilanit me mbështetjen e USAID-it, projekti Aktiviteti Kontrata Sociale, ka pilotuar konceptin e buxhetimit me pjesëmarrje, duke siguruar transparencë dhe përfshirje të madhe të qytetarëve në vendimmarrje.

Komuna përkundër përpjekjeve për të pasuruar webfaqen e saj zyrtare, është gjetur në vështirësi për shkak të mirëmbajtjes së varfër nga ASHI-ja. Përkundër kësaj, përdorimi i mediave sociale ka shënuar trend të rritjes në përdorim dhe këtu prezantohen shumë aktivitete. Megjithatë, nevojat për përmirësimin e cilësisë së prezantimit të rezultateve, është evidente sidomos përdorimi i gjuhës dhe figurave që e bëjnë më dinamike dhe joshëse vizitën e mediave sociale që përdoren nga komuna.

### DOBITË E KOMUNIKIMIT

- Kabineti i Kryetarit të Komunës, në koordinim me Zyrën Komunale për Informim dhe udhëheqësit e Komunës ndërtojnë mesazhe të qarta dhe koncize për publikun duke shkëmbyer informata
- Shfrytëzimi ditor dhe përdorimi i komunikimit përmes mediave elektronike/online dhe platformave të ndryshme sociale, forumeve online, video konference etj.
- Komunikimi përmes raporteve, artikujve, mesazheve – komunikimi vizuel – përmes imazheve, infografikave, diagrameve, videove etj.
- Marrëdhënie të mira me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, mediave etj.
- Ngritje të kapaciteteve informuese të zyrtarëve komunalë mbi rolin dhe rëndësinë e komunikimit efektiv për nevoja të informimit dhe zhvillimit.
- Interesimi i lartë i medimeve lokale (por jo vetëm – edhe rajonale dhe qendrore) në lidhje me pjesëmarrjen e qytetarëve nëpër takime të ndryshme.

### DOBËSITË E KOMUNIKIMIT

- Mungesa e burimeve të planifikuara financiare dhe njerëzore për të pasur një komunikim më të mirë me publikun
- Mungesa e resurseve financiare dhe kapaciteteve të OJQ-ve lokale për nxitur dhe mbështetur nismat për qytetari aktive dhe pjesëmarrje në procese të ndryshme vendimmarrëse

### PLANI VJETOR I KOMUNIKIMIT

Me qëllim të arritjes së synimit dhe objektivave strategjike të komunikimit, plani i veprimit për komunikim të brendshëm do të zhvillohet mbi baza të vitit kalendarik përgjatë periudhës që mbulon kjo strategji e komunës për komunikim.

## PLATFORMA DHE KANALET PËR KOMUNIKIM

Komuna e Gjilanit e ka për obligim që publikut t'i ofrojë informacione mbi prioritetet, politikat, programet, projektet, strategjitë, shërbimet dhe vendimet e saj. Platforma e komunës për informim dhe komunikim do të mbështetet në të drejtën e qytetarëve, mediave, organizatave të shoqërisë civile, hisedarëve dhe partnerëve për qasje të lirë, të drejtë dhe në kohë në informacionet që ndërlidhen me veprimtarinë e Komunës. Kjo platformë mbështetet në elementet e mëposhtme:

**Transparenca** – Duhet të jetë e ushtruar me anë të informimit me kohë dhe përmes mjeteve adekuate të komunikimit.

**Llogaridhënia** - parimi i llogaridhënies për punën e zyrtarëve komunalë karshi qytetarëve të komunës, në çështjet që ndërlidhen me buxhetin, financat dhe shpenzimet e buxhetit të komunës

**Përgjegjshmëria** – Komunikim i rregullt i zyrtarëve komunalë me qytetarët ofron përgjegjshmëri të udhëheqësve përballë premtimeve, sukseseve dhe dështimeve eventuale të komunës.

**Gjithëpërfshirja** – Mesazhet e autoriteteve të komunës do arrijnë tek të gjitha qytetarët në mënyrë që të ofrohet informimi i drejtë për të gjithë qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet tjera të interesit.

**Informimi me kohë** – informim në lidhje me vendimet, aktivitetet dhe planet e komunës, në mënyrë që qytetarët të jenë në gjendje të veprojnë në përputhje me informatën e pranuar.

**Mos diskriminimi** – informim i drejtë për të gjithë qytetarët e komunës, pa dallim gjinie, etnie, gjuhe, kulture apo religjioni. Marrja dhe adresimin i kërkesave nga ana e komunës, të të gjithëve pa asnjë dallim.

**Informata kthyesë** – siguron mundësi për qytetarët që të japin komentet, rekomandimet apo vërejtjet e tyre në lidhje me një informatë të cilin e pranojnë nga komuna. Kjo i mundëson komunës që të veprojë në përputhje me kërkesat e qytetarëve, me qëllim të përmirësimit të performancës së saj.

Komuna e Gjilanit do të rishikojë kanalet e komunikimit me audiencat e jashtme në mënyrë që aktivitetet, nismat dhe projektet e ndërmarra të pasqyrohen me korrektësi dhe të marrin vëmendjen e merituar te publiku. Komunikimet e Komunës së Gjilanit me audiencat e jashtme do të kalojnë përmes kanaleve si më poshtë:

### Kanalet e Komunikimit

**Webfaqja e Komunës** - <https://kk.rks-gov.net/gjilan/> mbetet kanali më i rëndësishëm i komunës për komunikim zyrtar me audiencat e jashtme. Ekzistojnë vështirësi serioze në qasje në këtë webfaqe dhe pas ridizajnit të faqes zyrtare të komunës nga ASHI, gradualisht dhe në muajt në vijim ajo duhet të ushqehet me informacionet relevante në funksion të informimit publik dhe qeverisjes së mirë dhe transparente.

**Mediat online dhe platformat sociale** - Kabineti i Kryetarit të komunës në koordinim me Zyrën komunale për Informim do të krijojë lista të konsoliduara për të gjitha audiencat, duke

përfshirë edhe mediat tek të cilat synon që të përcjellë ngjarjet që meritojnë vëmendjen e publikut. Duke pasur parasysh rritjen gjithnjë e më të madhe të popullaritetit të mediave të reja (digjitale), komuna duhet të kërkojë forma më efikase të komunikimit me to. Në momentin aktual, Komuna e Gjilanit është e pranishme vetëm në platformën sociale Facebook dhe Viber. Prania në platformat tjera sociale është një aspekt që do të adresohet që në vitin e parë (2024) me qëllim të hapjes të sa më shumë kanaleve të komunikimit digjital dhe përfshirjes të sa më shumë audiencave në komunikimet e ditëpërditshme.

**Publikimet** - Pjesa përmbajtjesore dhe vizuale e publikimeve zyrtare do të rishikohet në mënyrë që të jenë më të kuptueshme dhe vizualisht të kuptueshme, si dhe më të lexueshme nga publiku. Po ashtu, si publikimet formale ashtu edhe ato me karakter informimi e ndërjegjësimi do të standardizohen.

**Videot dhe fotografitë** - Videot dhe fotografitë, edhe si të vetme dhe të pashoqëruar me narracion ose me narracion të kufizuar, ka aftësinë për të kapur vëmendjen e audiencës, duke gjeneruar interesim dhe përfshirje emocionale.

**Format inovative të takimeve komunitare** - Takime të strukturuar dhe të planifikuara për organizimin dhe udhëheqjen e takimeve publike të natyrave konsultative - takimet dhe debatet publike, takimet konsultative, dëgjimet buxhetore, takimet komunitare për nisma dhe projekte kapitale, etj.

**Tabelat e informimit** - Komuna do të përkujdeset që në vendet më të frekuentuara të zonave urbane dhe rurale të vendosë tabelat të informimit të qytetarëve, në mënyrë që njoftimet, informacionet dhe mesazhet që duhen përcjellë të qytetarët të jenë të dukshme, të kuptueshme për publikun.

## SHTOJCAT:

### Shtojca 1.

#### Plani i veprimit për komunikim të brendshëm

#### AKTIVITETE SPECIFIKE

VEPRIMI	PERGJEGJESIA	AFATI KOHOR	KOSOTOJA
Krijimi i listave të kontaktit me audiencat e brendshme	Kabineti i Kryetarit të Komunës	Viti 2024/TM1	Pa kosto

Rishikimi i pakove të trajnimeve për zyrtarë komunalë me qëllimi të ngritjes së kapaciteteve	Kabineti i Kryetarit të Komunës / drejtoret e drejtorive	Viti 2024/TM1	Pa kosto
Hartimi i udhëzimeve për komunikim elektronik me audiencat e brendshme	Kabineti i Kryetarit të Komunës/DAP	Viti 2024/TM2	Pa kosto
Hartimi i formave të standardizuara të raportimit të brendshëm	Kabineti i Kryetarit të Komunës	Viti 2024/TM2	Pa kosto
Informim i rregullt dhe i strukturuar i të punësuarve që lidhen me administratën komunale dhe kuvendin e komunës	DAP/Njësia e Personelit/Njësia e Kuvendit	Viti 2024/TM3	Pa kosto

Shtojca 2.

### Plani i vjetor për komunikim të jashtëm

#### AKTIVITETE SPECIFIKE

VEPRIMI	PERGJESGJESIA	AFATI KOHOR	KOSOTOJA
Krijimi i listave dhe kontakteve me audiencën e jashtme	Kabineti i Kryetarit të Komunës	Viti 2024/TM1	Pa kosto
Miratimi i planit të transparencës ne kuvendin komunal	Ekziston Plani i Veprimt 2022-2026	Viti 2024/TM2	Pa kosto
Formimi i grupit punues për	Kabineti i Kryetarit të Komunës	Viti 2024/TM1	Pa kosto



identifikimin e mangësive të identifikuara nga indikatorët e transparencës			
Organizimi i takimeve apo punëtorive ndryshme	Kabineti i Kryetarit të Komunës	Viti 2024	Pa kosto
Organizimi i takimeve me donatorë të jashtëm dhe pjesëmarrja apo angazhimi në implementim të projekteve	Kabineti i Kryetarit të Komunës/ DZHE	Viti 2024	Pa kosto
Takimi publik i kryetarit të komunes me qytetare për paraqitjen e raportit të punës (gjashëmujor dhe vjetor)	Kabineti i kryetarit/DAP/ZIP	Viti 2024/TM2 Viti 2024/TM4	Pa kosto
Takime koordinuese të AZHR Lindje	DZHE	Viti 2024	Pa kosto
Ngjarjet kulturore artistike dhe sportive në Komune	DKRS	Viti 2024	Pa kosto

01.Nr. 016-128691

Gjilan, më 30.11.2023



Kryesuesi i KK Gjilan

Kushtrim Kadriu